

VENDIM
Nr. 102, datë 23.6.2016

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SHA LIDHUR ME MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT, SHËRBIMET NDIHMËSE DHE DISBALANCAT

Në mbështetje të neneve 1, 16 dhe 62, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.”; Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008 dhe nenit 26 të Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e “Miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”,

konstatoi se:

- Marrëveshja e miratuar me vendimin nr. 79, datë 7.6.2016, “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a”, i shtrin efektet e saj deri më 30 qershor 2016.

- Neni 62 i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikon se: *Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente.*

- a) *Procedurat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, miratohen nga ERE pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.*

- *Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të sigurojë energjinë elektrike për **mbulimin e humbjeve në rrjet, shërbimet e balancimit dhe ato ndihmëse me anë të kontratave bilaterale të miratuara nga ERE për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji**.*

- Aktualisht në tregun shqiptar të energjisë vetëm njësitë gjeneruese të të licencuarit KESH sh.a. mund të shërbejnë për sigurimin e shërbimeve ndihmëse.

- Koha për kryerjen e procedurave të prokurimit për muajin korrik të humbjeve në rrjetin e transmetimit është shumë e shkurtër.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e OST sh.a. për të lidhur kontratë bilaterale me pjesëtarin e tregut KESH sh.a., për të siguruar shërbimet ndihmëse dhe balancimit për periudhën e mbetur të vitit 2016.

2. Për qëllime të prokurimit të humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit për muajin korrik 2016, OST-ja t'i sigurojë humbjet nga KESH sh.a., me çmimin mesatar të bursës hungareze HUPEX të të njëjtit muaj, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse (www.hupe.hu).

3. Deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të rregullave të blerjes së energjisë elektrike, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, OST sh.a. të prokurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit në përputhje me “Rregulloren e procedurave të blerjes nga KESH sh.a., së energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj”, miratuar me vendimin nr. 30, datë 23.3.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti